



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PEJË - DEGA E GJYKATËS KLINË

---

Numri i lëndës: 2023:291602

Datë: 07.03.2024

Numri i dokumentit: 05426123

P.nr.208/2023

### NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE PEJË - DEGA NË KLINË, Departamenti i Përgjithshëm - Divizioni Penal, Gjyqtarja e vetme gjykuese Sabrije Rraci, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtores profesionale, Fatmire Elezaj, në çështjen penale kundër të pandehurit, F (F) P nga R rruga, Xh H,, nr.2100, për shkak të dyshimit të bazuar se ka kryer veprën penale, Posedim i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge nga neni 275 i Kodit Penal të Republikës së Kosovës, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Pejë, PP//II.nr.2491/2023, të datës 21.12.2023, në shqyrtimin fillestar publik të mbajtur në praninë e Prokurores së Shtetit, Arlinda Gacaferri nga Prokuroria Themelore në Pejë, dhe të pandehurit të lartcekur, pas përfundimit të shqyrtimit fillestar me datë,09.02.2024 në të njëjtën ditë mori dhe publikisht shpalli aktgjykimin, ndërsa me datë 07.03.2024, e përpiloi këtë:

### A K T G J Y K I M

Kundër:

I pandehuri F. P i lindur me datë ...., në fshatin B-K.M, i biri i F. dhe nënës A. e gjinisë P, me vendbanim në R., rruga „Xh H. ,kati i II,H nr.6,ka të kryer shkollën e mesme, i martuar baba i dy fëmijëve, me profesion murator, me nr. Personal...., i nacionalitetit shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, mbrohet në liri.

## ËSHTË FAJTOR

Për arsye se:

Me datë .... në ora .... në fshatin G-K-K, në veturën e markës „V,, ngjyrë e kuqe me targa 646-KS-647, pa autorizim posedon narkotikë dhe atë të llojit “M”, në atë mënyrë që, gjersa i pandehuri ishte duke qarkulluar me veturë, në të cilën pasagjer ishte i pandehuri I.R, të njëjtit i ndalon policia ku gjatë kontrollit në veturë, nën ulësen e pasagjerit policia gjen një qese me substancë narkotike të llojit „M,, me peshë neto prej 296,2440,001 gram, e cila substancë sekuestrohet nga zyrtarët policor pas kontrollit të përkohshëm për siguri.

- me çka ka kryer vepër penale, Posedimi i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge nga neni 275 par. 1 të KPRK-së.

Prandaj gjykata në bazë të neneve 4, 7, 17, 38, 43 dhe 69 dhe nenit 269 par. 1 të KPRK-së, si dhe nenit 364 të KPPRK-së:

## GJYKON

### DËNIM ME GJOBË DHE DËNIM ME KUSHT

I.Me dënim me gjobë shuma në vlerë prej 350 (treqind e pesëdhjetë) Euro, të cilën shumë obligohet i pandehuri që ta paguaj brenda afati kohor në kohë zgjatje prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

II.Nëse i pandehuri nuk dëshiron apo nuk mund ta paguaj gjobën e shqiptuar sipas afatit të dhënë, e njëjta gjobë do të zëvendësohet në dënim me burg, konform nenit 46 par.3 të KPRK-së, ku një ditë burgim do ti llogaritet në 20 Euro të gjobës.

### DËNIM ME KUSHT

III. Me dënim me burgim me kusht, në kohëzgjatje prej 1 (një) viti, i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse i akuzuari gjatë periudhës verifikuese prej 1 (një) viti nuk kryen vepër të re penale.

III. Obligohet i pandehuri që të paguaj shpenzimet procedurale konform nenit 453 par 1,i KPPRK-së shpenzimet e paushallit gjyqësor vlera në shumë prej 20 euro dhe për

kompensimin e viktimave të krimit 20 euro, brenda afati kohor në kohë zgjatje prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

## 1. Ecuria e procedurës penale

Prokuroria Themelore në Pejë- Departamenti i Përgjithshëm, pranë kësaj gjykate ka paraqitur aktakuzën, me shenjë, PP//II.nr.2491/23 datës 21.12.2023, kundër të pandehurit kundër të pandehurit F (F) P nga R, rruga „Xh.H,, nr.2100, për shkak të dyshimit të bazuar të se ka kryer veprën penale Posedim i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge nga neni 275 par.1 i Kodit Penal të Republikës së Kosovës.

Gjykata mbajti seancën e shqyrtimit fillestar me datë 09.02.2024, gjatë të cilës u dëgjuan Prokurorja e Shtetit, Arlinda Gacaferri nga Prokuroria Themelore në Pejë, i akuzuari i lartëcekur.

Pas leximit të aktakuzës nga prokurorja e shtetit, i pandehuri F. P, deklaroi e pranoi fajësinë për veprën penale që i vihet në barrë, jam i penduar thellë për veprën që e kam kryer dhe tani ndihem shumë keq, i pretoj gjykatës që më nuk do të përsërisë vepra të tilla apo të ngjashme.

Gjykata kërkon mendimin e prokurores së shtetit lidhur me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit.

Prokurorja e shtetit deklaroi: nuk e kundërshtojmë pranimin e fajësisë të deklaruar nga ana të pandehurit për veprën penale për të cilin akuzohet me qenëse një pranim i tillë u bë konform dispozitave ligjore të nenit 242 të KPPRK dhe është në përputhje të plotë me të gjitha provat personale me të cilat mbështet kjo akuzë, andaj nga gjykata kërkojë që të pandehurin ta shpall fajtor ta dënoj sipas ligjit si dhe ta obligoi në pagimin e shpenzimeve penale, ndërsa me rastin përcaktimit të llojit dhe lartësisë së dënimit pranimin fajësisë ta vlerësojë si rrethanë lehtësuese.

## 2. Vlerësimi i pranimin të fajësisë

Në shqyrtimin fillestar dhe publik, gjykata, pas dëgjimit të pandehurit, ka marrë aktvendim me të cilin e ka pranuar fajësinë nga i akuzuari i lartcekur, për veprën penale për të cilën është ngarkuar, ngase ka konstatuar se janë plotësuar të gjitha kushtet ligjore

nga neni 242 par. 1 të KPPK-së. Në këtë aspekt gjykata, ka konstatuar se i akuzuari e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimi të fajësisë dhe pas njoftimit nga ana e gjykatës lidhur me benifitet dhe pasojat e pranimi të fajësisë, ka vlerësuar se pranimi i fajësisë është bërë vullnetarisht nga i akuzuari, se pranimi i fajësisë mbështetet në faktet e çështjes që përmban aktakuza dhe se aktakuza nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabime faktike.

### 3. Gjendja faktike e vërtetuar:

Andaj duke u bazuar në këto që u cekën më lartë, gjykata, e ka vërtetuar këtë gjendje faktike se i akuzuari ka kryer veprën penale Posedimi i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge nga neni 275 par. 1 të KPRK-së, në kohën, vendin dhe mënyrën e përshkruar si në dispozitivin e këtij aktgjykimi.

### 4. Vendimi për shpalljen fajtor

Duke u bazuar në këto që u cekën më lart, gjykata ka vendosur që të akuzuarin, t'a shpallë fajtor për kryerjen e veprës penale sipas aktakuzës së cekur më lart, meqenëse është vërtetuar se i njëjti e ka kryer veprën penale siç edhe vet e ka pranuar sikurse në kohën, vendin dhe mënyrën e përshkruar sikurse në dispozitiv të aktgjykimit dhe për të njëjtën është përgjegjës. Kjo për faktin se e ka pranuar edhe vet.

### 5. Rrethanat që janë marrë për bazë me rastin e shqiptimit të dënimit:

Me rastin e shqiptimit të dënimit ndaj të akuzuarit, gjykata i ka marrë për bazë të gjitha rrethanat që ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit, sipas neneve 69 dhe 70 të KPK-së.

Në këtë aspekt, si rrethanë lehtësuese, mbi bazën e së cilës gjykata e ka shqiptuar dënimin për veprën penale sikurse më lart, është fakti se i akuzuari e ka pranuar fajësinë në shqyrtimin fillestar, ashtu që gjykatës i ka premtuar se nuk do ta përsërisë më vepra penale. Ndërsa, gjykata sa i përket rrethanave rënduese gjykata nuk gjeti asnjë rrethanë.

6. Shqiptimi i dënimit në harmoni me peshën e veprës penale dhe me shkallën e përgjegjësisë penale të akuzuarit dhe qëllimi i dënimit të shqiptuar.

Sipas bindjes së gjykatës, dënimi me burgim në kohëzgjatje prej 1 (një) viti, i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse i akuzuari gjatë periudhës verifikuese prej 1 (një) viti nuk kryen veprë të re penale, është dënim i drejtë, në harmoni me peshën e veprës penale dhe shkallën e përgjegjësisë penale të akuzuarit.

Dënimi me gjobë prej 350 (treqindë e pesëdhjetë) €, të cilën shumë obligohet i pandehuri që ta paguaj, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, duke i marrë për bazë rrethanat e përmendura më lartë, është dënim i drejtë, në harmoni me peshën e veprës penale dhe shkallën e përgjegjësisë penale të akuzuarit.

Gjykata ka konstatuar se me këto dënime mund të arrihet edhe qëllimi i dënimit, nga neni 38 i KPRK-së, i cili konsiston në parandalimin e të akuzuarit nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe të bëjë rehabilitimin e tij, por edhe (për mundësinë që të kthehet në një element kontribues për vete, familjen dhe për rrethin ku jeton) të parandaloj personat tjerë nga kryerja e veprave penale dhe të shpreh gjykimin shoqëror për veprën penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

Vendimi mbi shpenzimet u mor konform neni 453 par. 1 të KPRK-së.

Nga arsyet e cekura më lartë e në bazë të neneve 248 dhe neni 365 dhe 370 të KPRK-së është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

## GJYKATA THEMELORE NË PEJË-DEGA KLINË

### DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM

P.nr.208/2023 me datë 07.03.2024

Bashkëpunëtorja profesionale

Fatmire Elezaj

Gjyqtarja

Sabrije Rraci

### KËSHILLA JURIDIKE:

Kundër këtij aktgjykimi palët kanë te drejte te parashtrojnë ankesë në afat prej 30 ditësh, nga dita e marrjes. Ankesa i dërgohet Gjykatës së Apelit në Prishtinë përmes kësaj Gjykate.